ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **220/70100-26-3132-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **RITENDER -Sigurimi Fizik i Objekteve të QKUK-së**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**"Internat Security Association"SH.P.K.**
NUI	**601073042**
Adresa	**Mustafë Kruja nr.3**
Vendi	**PRISHTINË**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**049778877**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Fitim Gashi**
Adresa elektronike	**info@securityisa.org**
Data e parashtrimit të ankesës	**07.07.2026**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

RITENDER -Sigurimi Fizik i Objekteve të QKUK-së

Njoftimi per kontrate 07.05.2026 00:00

Data e planifikuar e hapjes se tenderit 17.06.2026 13:00

Vendimi i AK 23.06.2026 15:55

Kerkesa per rishqyrtim 25.06.2026

Vendim mbi refuzimin e kerkese per rishqyrtim 30.06.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kerkesa per rishqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7

ANKESË

Drejtuar: Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)

Lidhur me: Aktivitetin e Prokurimit Nr. 220/70100-26-3132-2-1-1 të zhvilluar nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK)

Ankues:
International Security Association Sh.P.K.

Operatori Ekonomik International Security Association Sh.P.K., në cilësinë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit dhe palës me interes juridik, në mbështetje të nenit 7, nenit 59, nenit 60, nenit 61, nenit 108 dhe nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar, si dhe brenda afatit ligjor të përcaktuar për ushtrimin e mjeteve juridike, paraqet këtë:

ANKESË

kundër Njoftimit për Dhënie të Kontratës, si dhe kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me të cilin është lënë në fuqi vendimi për shpërblimin me kontratë të Grupit të Operatorëve Ekonomikë të rekomanduar si fitues, për shkak se i njëjti është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, me kushtet obligative të Dosjes së Tenderit dhe me faktet e provuara në procedurën e prokurimit.

Ankuesi konsideron se vendimi i Autoritetit Kontraktues është marrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar, si dhe në kundërshtim me kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit.

Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar si të përgjegjshme një ofertë e cila nuk demonstron përmbushjen e kërkesave minimale të përcaktuara në Dosjen e Tenderit lidhur me analizën financiare dhe mbulimin e obligimeve ligjore që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.

Për më tepër, gjatë procedurës së rishqyrtimit, AK nuk ka bërë një analizë objektive të pretendimeve të paraqitura nga ankuesi, por është kufizuar në arsyetime të përgjithshme, pa verifikuar nëse analiza financiare e operatorit ekonomik fitues përmbushte realisht kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Për këtë arsye, vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është po ashtu i pabazuar në ligj dhe në faktet e konstatuara gjatë procedurës.

I. GJENDJA FAKTIKE

Autoriteti Kontraktues ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me numër 220/70100-26-3132-2-1-1 për ofrimin e shërbimeve të sigurimit fizik.

Në kuadër të këtij aktiviteti, Dosja e Tenderit ka përcaktuar kritere të qarta dhe detyruese për mënyrën e përgatitjes së analizës financiare, me qëllim që të garantohej se ofertat ekonomike mbulojnë të gjitha kostot ligjore të realizimit të kontratës.

Në mënyrë të veçantë, Dosja e Tenderit ka kërkuar që secili operator ekonomik të paraqesë një analizë financiare të detajuar për pagën bazë prej **500 euro bruto**, ku detyrimisht të përfshihen:

- paga bazë bruto;
- shtesat për punën gjatë natës;
- shtesat për punën gjatë vikendeve;
- shtesat për festat zyrtare;
- pushimi vjetor;
- kontributet pensionale;
- fitimi i operatorit ekonomik;
- TVSH;
- çmimi përfundimtar i ofertës.

Kjo kërkesë nuk është paraparë si dokument informues, por si kërkesë obligative e dosjes së tenderit, përmes së cilës Autoriteti Kontraktues do të verifikonte nëse oferta ekonomike mbulon të gjitha detyrimet minimale që burojnë nga legjislacioni në fuqi.

Ankuesi ka dorëzuar analizën financiare në përputhje me këto kërkesa.

Pas qasjes në dokumentacionin e operatorit ekonomik të shpallur fitues, ankuesi ka konstatuar se analiza financiare e grupit fitues nuk përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe nuk demonstron mbulimin e plotë të obligimeve ligjore që burojnë nga marrëdhënia e punës.

Për rrjedhojë, ankuesi ka ushtruar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, duke evidentuar në mënyrë të detajuar mangësitë e analizës financiare të grupit fitues dhe ndikimin e tyre në çmimin e ofertës.

Me vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues ka konsideruar se pretendimet e ankuesit janë të pabazuara, duke arsyetuar se operatori ekonomik fitues ka përdorur një metodologji tjetër të organizimit të punës dhe të llogaritjes së kostove, pa bërë një

verifikim të plotë nëse analiza financiare e tij përmbushte kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit.

Ky arsyetim, sipas ankuesit, nuk adreson thelbin e pretendimeve dhe nuk përmbush standardin e vleresimit te ofertave që kërkohet sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

II. KËRKESA OBLIGATIVE E DOSJES SË TENDERIT

Thelbi i këtij kontesti nuk lidhet me preferencën për një metodë të caktuar matematikore të kalkulimit, por me respektimin e kërkesave të përcaktuara nga vetë Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit.

Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues ka zgjedhur të kërkojë nga secili operator ekonomik jo vetëm ofertën financiare, por edhe një analizë të detajuar financiare, përmes së cilës operatori ekonomik duhej të demonstronte mënyrën e përllogaritjes së çmimit të ofertës dhe mbulimin e të gjitha obligimeve ligjore.

Kjo kërkesë ka karakter detyrues për të gjithë operatorët ekonomikë dhe nuk mund të trajtohet si dokument deklarativ apo orientues.

Në momentin kur Autoriteti Kontraktues e ka përfshirë këtë kërkesë në Dosjen e Tenderit, ajo është bërë pjesë përbërëse e kushteve të tenderit dhe, si e tillë, është detyruese si për operatorët ekonomikë ashtu edhe për vetë Autoritetin Kontraktues gjatë fazës së vlerësimit.

Rrjedhimisht, AK nuk kishte diskrecion të relativizonte ose të anashkalonte mospërmbushjen e kësaj kërkese, por kishte detyrim ligjor të verifikonte nëse analiza financiare e secilit operator ekonomik ishte në përputhje të plotë me elementet e kërkuara në Dosjen e Tenderit.

Mosushtrimi i këtij verifikimi përbën shkelje të detyrimit për ekzaminim dhe vlerësim objektiv të tenderëve, pasi oferta nuk mund të konsiderohet e përgjegjshme vetëm mbi bazën e deklarimeve të operatorit ekonomik, por duhet të mbështetet në dokumentacionin e dorëzuar dhe në përputhshmërinë e tij me kërkesat e tenderit.

III. SHKELJA E NENIT 59 TË LIGJIT PËR PROKURIMIN PUBLIK – MUNGESA E VLERËSIMIT OBJEKTIV TË OFERTËS

Një nga obligimet themelore të Autoritetit Kontraktues gjatë procedurës së prokurimit është ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

Neni 59 i LPP-së nuk i jep Autoritetit Kontraktues të drejtën që të supozojë ose të prezumojë se një ofertë është e përgjegjshme vetëm për shkak se operatori ekonomik ka deklaruar se do ta realizojë kontratën. Përkundrazi, ky nen imponon detyrimin që AK të verifikojë në mënyrë aktive dhe objektive nëse dokumentacioni i dorëzuar dëshmon përmbushjen e çdo kërkese të Dosjes së Tenderit.

Në rastin konkret, Dosja e Tenderit ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë të paraqesin një analizë financiare për pagën bazë prej 500 euro bruto, në të cilën duhet të pasqyrohen të gjitha obligimet ligjore që burojnë nga legjislacioni në fuqi, përfshirë pagesat shtesë për punën gjatë natës, vikendeve, festave zyrtare, pushimin vjetor, kontributet pensionale, fitimin dhe TVSH-në.

Nga vetë formulimi i kësaj kërkese rezulton se analiza financiare nuk është kërkuar vetëm si një dokument formal, por si instrument përmes të cilit Autoriteti Kontraktues do të verifikonte nëse çmimi i ofertës mbulon të gjitha kostot minimale ligjore të realizimit të kontratës.

Pikërisht në këtë pikë qëndron shkelja e bërë nga Autoriteti Kontraktues.

Në vend që të verifikojë nëse analiza financiare e grupit të operatorëve ekonomikë fitues përmbushte kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues është mjaftuar me pranimin e shpjegimit të operatorit ekonomik lidhur me mënyrën e organizimit të ndërrimeve të punës.

Me këtë veprim, AK nuk ka analizuar nëse:

- numri i punëtorëve të përfshirë në kalkulim korrespondon me numrin e kërkuar sipas specifikimeve teknike;
- janë përfshirë të gjitha kostot minimale të kërkuara nga Dosja e Tenderit;
- vlerat e paraqitura për shtesat ligjore mbulojnë realisht obligimet që rrjedhin nga legjislacioni i punës;
- analiza financiare justifikon çmimin përfundimtar të ofertës.

Në këtë mënyrë, Autoriteti Kontraktues nuk ka kryer verifikimin material të dokumentacionit, por vetëm ka pranuar deklarimet e operatorit ekonomik fitues, gjë që bie ndesh me detyrimin e tij ligjor sipas nenit 59 të LPP-së.

Ky detyrim nuk mund të zëvendësohet me supozime apo me pranimin pa verifikim të shpjegimeve të operatorit ekonomik, sepse përndryshe analiza financiare do të humbte krejtësisht funksionin për të cilin është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

IV. AUTORITETI KONTRAKTUES KA NDRYSHUAR NË MËNYRË TË PALEJUAR KËRKESAT E DOSJES SË TENDERIT GJATE VLERESIMIT TE OFERTAVE

Një tjetër shkelje thelbësore konsiston në faktin se, gjatë procedurës së rishqyrtimit, Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar kriteret që vetë i kishte përcaktuar në Dosjen e Tenderit, por ka krijuar një standard të ri vlerësimi.

Dosja e Tenderit nuk ka paraparë që operatorët ekonomikë mund të përdorin metoda të ndryshme të kalkulimit pa dëshmuar se ato mbulojnë të gjitha obligimet ligjore.

Përkundrazi, ajo ka kërkuar që analiza financiare të pasqyrojë të gjitha këto obligime.

Në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues nuk analizon nëse secili prej këtyre elementeve është përfshirë në analizën financiare të operatorit fitues, por arsyeton se operatori ekonomik ka përdorur një metodologji tjetër të organizimit të punës.

Ky arsyetim nuk është i mbështetur në Dosjen e Tenderit.

Asnjë dispozitë e Dosjes së Tenderit nuk autorizon Autoritetin Kontraktues që, pas hapjes së ofertave, të relativizojë ose të ndryshojë kriteret mbi të cilat do të vlerësohen analizat financiare.

Nëse Autoriteti Kontraktues ka konsideruar se mjafton një metodologji e përgjithshme e kalkulimit pa verifikimin e mbulimit të obligimeve ligjore, atëherë ai ka ndryshuar në mënyrë substanciale kriteret e vlerësimit pas përfundimit të afatit për dorëzimin e ofertave.

Një veprim i tillë cenon parimin e sigurisë juridike, transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Ankuesi e ka përgatitur ofertën e tij duke respektuar kërkesat e Dosjes së Tenderit ashtu siç janë publikuar. Nuk është e lejueshme që pas dorëzimit të ofertave Autoriteti Kontraktues të aplikojë një standard tjetër vetëm për operatorin ekonomik fitues.

V. SHKELJA E NENIT 60 TË LPP-së – OFERTA FITUESE NUK MUND TË KONSIDEROHET OFERTË E PËRGJEGJSHME

Sipas Ligjit për Prokurimin Publik, kontrata publike mund t'i jepet vetëm një operatori ekonomik që ka paraqitur një **tender të përgjegjshëm**, i cili përmbush të gjitha kërkesat materiale të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Koncepti i "tenderit të përgjegjshëm" nuk lidhet vetëm me dorëzimin formal të dokumenteve, por me përmbajtjen e tyre dhe aftësinë e tyre për të dëshmuar se operatori ekonomik i plotëson kushtet e kërkuara.

Në rastin konkret, analiza financiare përbënte pjesë integrale të ofertës dhe kishte funksionin të demonstronte se çmimi i ofertës mbulon të gjitha detyrimet ligjore që lidhen me realizimin e kontratës.

Nëse analiza financiare nuk i përmbush këto kërkesa, atëherë edhe oferta humb karakterin e saj si ofertë e përgjegjshme.

Autoriteti Kontraktues nuk ka konstatuar në mënyrë të argumentuar se analiza financiare e grupit fitues përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit, por vetëm ka pranuar shpjegimin e operatorit ekonomik lidhur me metodologjinë e përdorur.

Një arsyetim i tillë nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur standardin e kërkuar nga neni 60 i LPP-së, sepse nuk demonstron se oferta fituese është në përputhje me të gjitha kërkesat materiale të procedurës së prokurimit.

VI. SHKELJA E NENIT 61 TË LPP-së – MUNGESA E SHQYRTIMIT TË ÇMIMIT DHE ANALIZËS FINANCIARE

Edhe pse Autoriteti Kontraktues në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim ka pretenduar se operatori ekonomik fitues ka përdorur një metodologji tjetër të organizimit të ndërrimeve të punës, ai nuk ka kryer analizën që kërkohet nga Ligji për Prokurimin Publik kur paraqiten dyshime serioze mbi aftësinë e ofertës për të mbuluar të gjitha kostot ligjore të realizimit të kontratës.

Pretendimi i ankuesit nuk është se operatori ekonomik fitues nuk kishte të drejtë të organizojë ndryshe punën.

Pretendimi është se analiza financiare e dorëzuar prej tij nuk demonstron se çmimi i ofertës mbulon të gjitha detyrimet ligjore të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Kjo përbën dallim thelbësor.

Autoriteti Kontraktues nuk ka analizuar:

- nëse numri i punëtorëve i përdorur në kalkulim korrespondon me kërkesat e specifikimeve teknike;
- nëse janë përllogaritur në tërësi shtesat për punën gjatë natës, vikendeve dhe festave;
- nëse çmimi i ofertës mbulon realisht kostot minimale të punësimit;
- nëse analiza financiare është në përputhje me elementet e detyrueshme të Dosjes së Tenderit.

Në mungesë të një analize të tillë, AK nuk ka pasur bazë faktike dhe juridike për të konstatuar se oferta e grupit fitues ishte ofertë e përgjegjshme.

Në procedurat e prokurimit publik, kur një operator ekonomik paraqet argumente konkrete dhe të dokumentuara se analiza financiare e ofertës fituese nuk mbulon detyrimet minimale ligjore, Autoriteti Kontraktues nuk mund ta refuzojë këtë pretendim vetëm me një shpjegim të përgjithshëm mbi organizimin e punës.

Ai ka detyrim të verifikojë, të dokumentojë dhe të arsyetojë mbi bazën e provave objektive pse oferta e kontestuar vazhdon të konsiderohet e përgjegjshme.

Vendimi i kontestuar nuk përmban një analizë të tillë.

VII. AUTORITETI KONTRAKTUES NUK KA ARSYETUAR VENDIMIN SIPAS STANDARDEVE TË LPP-së

Një vendim administrativ nuk konsiderohet i ligjshëm vetëm pse përmban një përfundim.

Ai duhet të përmbajë edhe arsyetimin mbi të cilin është ndërtuar ai përfundim.

Në rastin konkret, AK nuk ka bërë analizë të dokumenteve financiare të operatorit ekonomik fitues.

Nuk ka krahasuar analizën financiare me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Nuk ka analizuar përllogaritjen e secilit element të detyrueshëm.

Nuk ka shpjeguar pse diferencat e evidentuara nga ankuesi nuk ndikojnë në përgjegjshmërinë e ofertës.

Në vend të kësaj, AK është kufizuar në konstatimin se operatori ekonomik fitues përdor një organizim tjetër të ndërrimeve.

Një arsyetim i tillë nuk i përgjigjet pretendimit ankimor.

Pretendimi i ankuesit nuk kishte të bënte me mënyrën e organizimit të turneve, por me faktin se analiza financiare nuk demonstron mbulimin e plotë të kostove që vetë Autoriteti Kontraktues kishte kërkuar të pasqyroheshin në Dosjen e Tenderit.

Prandaj, vendimi i kontestuar nuk përmbush standardin minimal të arsyetimit administrativ dhe nuk mund t'i rezistojë kontrollit ligjor nga OSHP.

VIII. SHKELJA E PARIMIT TË TRAJTIMIT TË BARABARTË (NENI 7 I LPP-së)

Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton që të gjithë operatorët ekonomikë duhet të vlerësohen sipas të njëjtave kritere dhe të njëjtit standard.

Në rastin konkret, ankuesi ka përgatitur analizën financiare duke përfshirë të gjitha elementet e kërkuara nga Dosja e Tenderit dhe duke llogaritur kostot në mënyrë që të sigurohet mbulimi i plotë i detyrimeve ligjore.

Ndërkohë, grupi i operatorëve ekonomikë fitues është vlerësuar si i përgjegjshëm edhe pse, sipas pretendimeve të argumentuara të ankuesit, analiza e tij financiare nuk demonstron përfshirjen e plotë të këtyre elementeve.

Nëse Autoriteti Kontraktues pranon standarde të ndryshme të vlerësimit për operatorë të ndryshëm ekonomikë, atëherë cenon drejtpërdrejt parimin e trajtimit të barabartë dhe të konkurrencës së ndershme.

Ky parim nuk mbrohet vetëm duke u dhënë të gjithëve mundësinë për të ofertuar.

Ai mbrohet duke i nënshtruar të gjithë operatorët ekonomikë të njëjtit standard të kontrollit dhe të njëjtit nivel verifikimi.

Në rastin konkret, kjo nuk ka ndodhur.

IX. KUNDËRSHTIMI I ARSYETIMIT TË AK-së

Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim mbështetet në premisën se operatori ekonomik fitues ka përdorur një metodologji tjetër të organizimit të punës.

Ky arsyetim nuk mund të pranohet për disa arsye:

Së pari, Dosja e Tenderit nuk ka kërkuar paraqitjen e një modeli organizativ të ndërrimeve, por një analizë financiare që pasqyron të gjitha obligimet ligjore.

Së dyti, edhe nëse ekzistojnë metoda të ndryshme të organizimit të punës, secila prej tyre duhet të rezultojë në një analizë financiare që mbulon të gjitha kostot minimale ligjore.

Së treti, AK nuk ka provuar me asnjë analizë financiare se metodologjia e operatorit fitues prodhon të njëjtin rezultat ekonomik dhe garanton mbulimin e të gjitha detyrimeve të kërkuara.

Së katërti, vendimi nuk përmban asnjë verifikim të numrit të punëtorëve të përdorur në kalkulim, të kostove të ndërrimeve të natës, vikendeve, festave zyrtare, pushimeve vjetore apo elementeve të tjera të kërkuara në Dosjen e Tenderit.

Për rrjedhojë, vendimi nuk rrëzon pretendimet e ankuesit, por vetëm i anashkalon ato.

X. VLERËSIMI I PASAKTË I PRETENDIMEVE TË ANKUESIT

Nga përmbajtja e vendimit rezulton se Autoriteti Kontraktues nuk i ka trajtuar pretendimet e kerkeses sone te cilat I kemi parashtruar ne kerkesen per rishqyrtim në tërësinë e tyre.

Në vend të analizës së secilit pretendim të ngritur në kërkesën për rishqyrtim, vendimi I AK fokusohet pothuajse ekskluzivisht në çështjen e organizimit të turneve të punës.

Megjithatë, kërkesa për rishqyrtim nuk ishte e kufizuar vetëm në këtë element.

Ne si OE, kemi ngritur çështjet që lidhen me:

- numrin e punëtorëve të përdorur në kalkulim;
- përllogaritjen e shtesave ligjore;
- ndikimin e këtyre elementeve në çmimin përfundimtar të ofertës;
- përputhshmërinë e analizës financiare me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Vendimi I AK nuk përmban analizë të veçantë për secilin prej këtyre pretendimeve dhe, për këtë arsye, nuk mund të konsiderohet si një vendim i arsyetuar në kuptimin e standardeve të procedurës administrative dhe të Ligjit për Prokurimin Publik.

Në rastin konkret, ashtu sic kemi paraqitur edhe faktet e pamohueshme ne kerkesen tone per rishqyrtim, ne nuk kemi pretenduar se operatori ekonomik fitues ka bërë vetëm një gabim aritmetik.

Pretendimi është shumë më serioz.

Pretendimi është se analiza financiare nuk demonstron mbulimin e plotë të elementeve të kërkuara nga Dosja e Tenderit dhe, si rezultat, çmimi i ofertës është ndërtuar mbi një bazë financiare që nuk përputhet me kërkesat e procedurës së prokurimit.

Nëse një analizë financiare nuk pasqyron në mënyrë të plotë elementet e kërkuara nga Dosja e Tenderit, atëherë nuk është e mundur të konstatohet se oferta ekonomike është ndërtuar mbi një bazë reale dhe të qëndrueshme.

Për këtë arsye, AK kishte detyrimin të verifikonte jo vetëm ekzistencën formale të analizës financiare, por edhe përmbajtjen e saj.

Pyetja juridike që duhej të merrte përgjigje ishte:

A demonstron analiza financiare se operatori ekonomik fitues ka përfshirë dhe përllogaritur të gjitha kostot e kërkuara?

Pikërisht kësaj pyetjeje nuk i përgjigjet vendimi i AK-së.

Në vendim nuk ekziston asnjë analizë financiare.

Nuk ekziston asnjë tabelë krahasuese.

Nuk ekziston asnjë verifikim.

Nuk ekziston asnjë ekspertizë.

Ekziston vetëm përfundimi.

Një përfundim pa analizë nuk mund të konsiderohet arsyetim.

XI. VENDIMI I AK-së NUK PËRMBUSH STANDARDIN E ARSYETIMIT

Parimi i arsyetimit të vendimeve administrative kërkon që çdo pretendim i palës të marrë përgjigje të qartë, konkrete dhe të mbështetur në prova.

Në rastin konkret ankuesi ka paraqitur:

- dispozitën konkrete të Dosjes së Tenderit;
- elementin konkret të analizës financiare;
- llogaritjen konkrete;
- ndikimin konkret në çmimin e ofertës.

Autoriteti Kontraktues nuk ka kundërshtuar asnjë prej këtyre elementeve me prova.

Ai nuk ka paraqitur:

- analizë financiare alternative;
- ekspertizë financiare;
- tabelë krahasuese;
- përllogaritje ekonomike;
- verifikim të analizës së operatorit fitues.

Në mungesë të këtyre elementeve, vendimi mbetet deklarativ.

Deklarimet e përgjithshme nuk mund të zëvendësojnë analizën objektive që kërkohet nga Ligji për Prokurimin Publik.

XII. PËRFUNDIMI

Nga të gjitha provat e administruara rezulton se:

- Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë verifikimin material të analizës financiare të operatorit ekonomik fitues.
- Nuk ka analizuar përputhshmërinë e saj me kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit.
- Nuk ka dhënë përgjigje të arsyetuar ndaj pretendimeve të ngritura në kërkesën për rishqyrtim.
- Ka relativizuar kriteret e Dosjes së Tenderit pas dorëzimit të ofertave.
- Ka shpallur fitues një ofertë pa provuar se ajo përmbush të gjitha kërkesat materiale të procedurës.

Për rrjedhojë, vendimi për dhënien e kontratës dhe vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim janë nxjerrë në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik dhe duhet të anulohen.

Duke u mbështetur në faktet e paraqitura, provat e administruara, dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar

Duke u bazuar në dispozitat ligjore te LPP-se:

- nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik;
- nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik;
- nenin 60 të Ligjit për Prokurimin Publik;
- nenin 61 të Ligjit për Prokurimin Publik;

si dhe kushtet obligative të Dosjes së Tenderit, i propozojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit që, pas shqyrtimit të kësaj ankese dhe vlerësimit të të gjitha provave dhe argumenteve të paraqitura, të nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Të aprovohet si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik *International Security Association Sh.P.K.*;**

2. **Të anulohet Vendimi i Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, si i nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe kushtet e Dosjes së Tenderit;**
3. **Të anulohet Njoftimi për Dhënie të Kontratës për aktivitetin e prokurimit nr. 220/70100-26-3132-2-1-1;**
4. **Lënda të kthehet në rivlerësim, duke obliguar Autoritetin Kontraktues që gjatë rivlerësimit të bëjë një ekzaminim dhe vlerësim të plotë, objektiv dhe të paanshëm të të gjitha ofertave, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, kushtet e Dosjes së Tenderit dhe arsyetimin e vendimit të OSHP-së;**
5. **Të urdhërohet Autoriteti Kontraktues që, gjatë rivlerësimit, të verifikojë në mënyrë të plotë përputhshmërinë e analizës financiare të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë me kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit dhe me legjislacionin në fuqi, duke siguruar që oferta e shpallur fituese të jetë ofertë e përgjegjshme në kuptim të Ligjit për Prokurimin Publik.**

Neni 59
Neni 60
Neni 61
neni 62

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Mundesia e Shperblimit me Kontrate

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*